



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/39

Datë: 03.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" Sh.A.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Ndërmarrjes nga pika 1 me këtë përbërje:
 - 2.1. z. Bajram Mustafa, kryesues dhe drejtor;
 - 2.2. znj. Nora Ibishaga, drejtore;
 - 2.3. z. Bislim Fetahaj, drejtor; dhe
 - 2.4. z. Edin Hajdarpašić, drejtor.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- KRU "Mitrovica" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	25.4.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre në detyrë, MEPTINIS
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për shkakimin e bordit të drejtorëve dhe emërimin e bordit të përkohshëm të KRU “Mitrovica” Sh.A.

I nderuar Kryeministër Kurti,
i nderuar zëvendëskryeministër Abazi,
të nderuar ministra:

I propozoj Qeverisë të shkarkojë bordin e drejtorëve dhe të emërojë një bord të përkohshëm në KRU “Mitrovica”. Sipas nenit 19.3 të Ligjit për ndërmarrjet publike, Qeveria duhet të shkarkojë drejtorët kur ka “arsye për të besuar” se kanë shkelur detyrat fiduciare.

Pasqyrat financiare të ndërmarrjes për vitin 2018 janë audituar nga kompania “Audit Group” sh.p.k., e cila ka dhënë opinion të kualifikuar. Kjo i bie se pasqyrat nuk janë plotësisht në përputhje me standardit e kontabilitetit, sipas ligjit. Nuk ka prova se drejtorët e tanishëm kanë thirrur në përgjegjësi zyrtarët që kanë përgatitur pasqyrat.

Për më tepër, ndërmarrja ka dështuar në realizimin e projekteve me përkrahje ndërkombëtare. Si pasojë e mosveprimit të bordit dhe të menaxhmentit, është tërhequr ndihma nga Luksemburgu, i vetmi donator për ndërmarrjen. Këto rrethana i japin Qeverisë arsye të besojë se drejtorët kanë shkelur detyrat fiduciare.

Kur shkarkohet bordi, Qeveria duhet të emërojë sa më shpejt një bord të përkohshëm, që shërben deri në zgjedhjen e bordit me mandat të plotë, por jo më shumë se 6 muaj (neni 43 LNP). Kandidatët e paraqitur në këtë propozim-vendim janë ekspertë të qeverisjes korporative dhe të fushave në të cilat operon ndërmarrja.

Rrjedhimisht, ftoj Qeverinë të nxjerrë vendim për bordin e KRU Mitrovicës.

Rozeta HAJDARI

Ministre në detyrë